



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së gjashtë të Komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara,
mbajtur më 08.11.2021, e cila filloi në orën 13:30.**

**Në mbledhje morën pjesë: Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, dhe anëtarët e komitetit:
Ramadan Salihu, Mehreme Llumnica, Armend Ademi dhe Ermira Shabani.**

Munguan: Jeton Canhasi, Gyltene Retkoceri.

**Në mbledhje ishin të pranishëm: Premtime Preniqi, koordinatore e Njësisë për të drejtat e
njeriut dhe Besa Preniqi, interprete.**

**Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, duke ua dhënë fjalën
anëtarëve të komitetit që ti propozojnë pikat e rendit të ditës.**

Kryesuesja konstatoi se u miratua ky

REND DITE:

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestët të Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara;**
- 2. Diskutim rreth 3 Dhjetorit - Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara;**
- 3. Të ndryshme.**

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara.

Armend Ademi kërkoi që të diskutimi i tij në faqen 7, është "Vjollcën" të përmirësohet të jetë "Vjosën".

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së pestë të Komitetit konsultativ të personave me aftësi të kufizuara.

Pika e dytë

Diskutim rreth 3 Dhjetorit - Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, bëri të ditur se e ka diskutuar edhe me Premtimen idenë lidhur më 3 Dhjetorin - Ditës Ndërkombëtare të PAK, që t'i ftojme komitetet që janë në kuadër të Kosovës, t'i ftojme në Komunën e Prishtinës dhe ta shënojmë 3 dhjetorin, por kjo kishte pengësë për shkak të fushatës zgjedhore dhe nuk e dimë mandatin e kryetarëve se a zgjidhen deri më 3 dhjetor a jo, e t'i ftojme ata e të mos kemi mundësi tu ofrojmë një ujë, një kafe, një drekë, do të ishte shumë vështirë me u realizuar nga ana e Komunës, mirëpo ta diskutojmë këtu në komitet se a jeni dakord me këtë ide apo dëshirojmë diçka tjetër.

Premtime Preniqi, sa i përket çështjes së shërbimit me kafe, ushqim etj., mundeni me iu drejtuar Muhedin Nushit dhe ai u përgjigjet a ju lejohet a jo. Më herët e kanë pasur një kontratë me Liburninë, por a ekziston ajo kontratë nuk di. Sa i përket ftesës se sa komuna kanë Komitet të PAK, nuk e kam as këtë informatë.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, tha se në bazë të informatave që kemi, janë 5-6 komuna që e kanë këtë Komitetin.

Ramadan Salihu tha se nëse i ftojme, atëherë duhet ftuar shoqatat që i përfaqësojnë PAK-të, për me pa se ku janë dhe ku jemi ne, por Komitete në mënyrë individuale, sepse kur t'i thirrësh duhet me i pyetur, duhet me ditur ata për çka po i thërrasim në qoftë se ne jemi për një trup koordinativ, veç t'i thërrasim për eksperiencë dhe përvoja, kjo shkon në mënyrë individuale njeri me tjetrin, ne shkojmë në ndonjë komunë ata vine te ne.

Ermira Shabani u shpreh e pajtimit që me u lidhur me komitetet e PAK, por ne mundemi me bërë në formatin online me të gjitha komitetet, faktikisht cili kishte qenë qëllimi i atij takimi. Do të ishte p.sh përfaqësuesi i Komitetit të komunës së Prishtinës e jap një informacion se në çfarë gjendje është aftësia e kufizuar në Komunën e Prishtinës, njëjtë me prezantuar edhe përfaqësuesit e komunave tjera se si është situata e aftësive të kufizuara në komunën e tyre, dhe nga ky takim të dalin rekomandime dha ato rekomandime mundemi me ia dërguar nivelit qendror dhe nivelit lokal, të gjitha komunave, Asociacionit të Komunave, ku ky do të ishte një aktivitet dhe shihet se ku jemi.

Takimi tjetër kishte mundur me qenë Komuna e Prishtinës, me mbajtur takim fizik, me caktuar ditën, i caktojmë cilat organizata ti ftojme, si të Autizmit, Sindron Daun, Hendikos etj.

Armend Ademi tha se nuk e di kur zgjidhen kryetarët, kur e marrin detyrën e re.

Premtime Preniqi tha se në muajin janar.

Armend Ademi, po të ishte bërë më herët, atëherë do të kishim ditur me kë po dëshirojmë takim.

Po ashtu, ai pyeti se a e mban pozitën kryetari i tanishëm deri sa të vjen tjetri.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, u përgjigj po, por nuk ke nevojë me i ftuar kryetarët.

Premtime Preniqi tha se është fjala për kryetarë të komiteteve jo komunave.

Ermira Shabani tha se me rëndësi është me mbajtur një takim të Komitetit dhe me nxjerrë një dokument, dhe kushdo që vjen kryetar dhe kur të vjen, e ka atë dokumente që do të duhej ta shikonte ndonjëherë.

Premtime Preniqi tha për kryetarin në ardhje, secili që është, do të ishte mirë me pasur mundësi me caktuar një takim dhe në njëfarë mënyre me i obliguar me disa kërkesa që ata me premtuar.

Mehreme Llumnica tha se këtë hap e kanë marrë disa OJQ, p.sh. Hendikosi me marrëveshje mirëkuptimi i ka shkruar disa pika, këto janë nevoja, ti keni në programin tuaj këto dhe ai me u nënshkruar si lloj betimi.

Për propozimin që e cekët, më 3 dhjetor me i ftuar përfaqësuesit e OJQ-ve, shumë pak kanë me ardhur se janë shumë të ngarkuar me aktivitete.

Ramadan Salihu theksoi se nuk është e thënë vetëm me 3 dhjetor me ardhur ata këtu, por mundemi me 2 dhjetor, por edhe nëse është i nxënë kryetari, mundet me dërguar ndonjë përfaqësues të vetin, megjithatë bëhet një farë pune që ia vlen me ardhur, mirëpo me pasur çka me diskutuar e jo mos me pas çka me thënë aty.

Mehreme Llumnica tha se mua mu ka drejtuar stafi përgjegjës i Hendikosit, çka ka bërë Komiteti për PAK, çka keni bërë diçka ndryshim.

Premtime Preniqi theksoi se nuk mundemi me thënë që në Komitet nuk është bërë asgjë, për shkak se faktikisht janë parë krejt ato pikat e dobëta që i ka Komuna në aspekt me PAK dhe është lobuar deri në atë kufirin ku mundet me lobuar, e tani sa mundesh me i ndryshua gjërat, ne nuk po mundemi me i ndryshua edhe do gjëra ma të lehta, e le më pjesën që është më e ndjeshme. Si komitet kemi bërë boll, se është ndie zëri juaj, se keni shkuar në Drejtorinë e Arsimit, Burimet njerëzor, nënkryetari janë njoftuar ma ato çështje që ka qenë problemi. Ju pjesën e juaj e keni kryer, ma shumë nuk mundeni.

Ramadan Salihu, duke iu drejtua Mehremes dhe Armendit, tha se po më intereson se ju që po përfaqësoni OJQ, PAK, a ia vlen me iniciuar formimin e trupit koordinues në mes të komiteteve.

Mehreme Llumnica shprehu mendimin se në një aspekt ia kishte vlejtur, për arsye se me shkëmbyer përvoja njëri prej tjetrit dhe prej Asociacionit të Komunave me shty diçka për çështjen e PAK. Tash kjo është me rregullore dhe me ligj.

Armend Ademi theksoi se ndoshta kishte qenë mirë të paktën me qenë me 3 dhjetor prej komiteteve ekzistuese që janë me i thirrur vetëm një përfaqësues dhe me i prezantuar secili Komitet të arriturat e veta.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, tha se ne po i përkushtohemi datës 3 dhjetor, ne mundemi këtë takim me mbajtur më 2 dhjetor, që me u liruar krejt në datën 3 dhjetor, se gjithë kemi angazhime shtesë atë ditë, kështu që më 2 dhjetor të vendos komiteti ose takim online ose fizike me një përfaqësues të komiteteve.

Ramadan Salihu tha se kjo është qasja më efikase për me shkua te secila ose me ardhur ata.

Ermira Shabani shprehu mendimin se edhe një takim online ia kishë vlejtur se është shkëmbim i përvojave, njohurive.

Ramadan Salihu pyeti se kush e udhëheq atë takim, kush e cakton rendin e ditës dhe kush e përmbyll atë takim.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, tha se nëse ftesa është prej Prishtinës, atëherë e udhëheq Prishtina, ftesën, agjendën etj., d.m.th. Komiteti i Prishtinës.

Mehreme Llumnica tha se është me rëndësi me mbajtur një takim paraprak me propozime të qarta, me marrë atë iniciativë a mundem me shkuar, është Qendra e Karrierës, mundemi me shkuar.

Ermira Shabani u shpreh në përkrahje të takimit online.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, tha se unë me gjithë dëshirë pajtohem me qëndrimin e Ermirës, por duke pasur frikë mos nuk kemi njerëz që e marrin përgjegjësi me thirre në telefon, tjetri me krijuar emaile, tjetri "Zoom" etj. se tetë komitete PAK po dalin, nëse e kemi vetëm Ferizajin e kemi më lehtë se i gjejmë kontaktet me Ferizajn direkt në Komunë pyesim.

Ermira Shabani theksoi se jam e gatshme me marrë përgjegjësinë me i dërguar e-mailet, por Fatimja besoj se më ndihmon me i siguruar e-mailet e të gjitha komiteteve, së bashku me Mehremen, e dikush me marrë përgjegjësinë me folur për Komunën e Prishtinës, cilat janë sfidat dhe të arriturat.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, u shpreh e gatshme që t'i siguroj të gjitha e-mailet e komiteteve.

Ermira Shabani tha se do t'i shkruajmë e-mailet, me iu bërë ftesën, me caktuar saktësisht një agentë, mund ta hap likun për takim dhe në fund kërkoj ndihmën e juaj në përpilimin e dokumentit me rekomandime.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, tha se për ta përpiluar dokumentin me rekomandime e kemi zotëri Ramadanin.

Ramadan Salihu theksoi që le të shkojnë dy propozimet, cilën mundemi me realizuar edhe me shkua ku kemi mundësi.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, konstatoi se anëtarët e Komitetit u pajtuan që më 1 dhjetor ta organizojnë takimin me Komitetin e Ferizajt, me shkuar Komiteti PAK i Prishtinës në Ferizaj dhe më 2 dhjetor të mbajmë takim online me komitetet tjera.

Ermira Shabani tha së pari e tregoni datën dhe me konfirmuar pjesëmarrjen. Kur ta konfirmojnë pjesëmarrjen ju tregojmë prej kësaj ore. Unë po mendoj me iu thënë atyre bëni nga një prezantim si "pover point" dhe me treguar për komunën e vet, ku janë si janë, sikur po kanë nevojë me u takuar me Komitetin e Prishtinës.

Premtime Preniqi tha se të njëjtën prezantim duhet me përgatitur edhe Komuna e Prishtinës, këtë prezantimin e bën Ramadani ose Fatimja.

Armend Ademi propozoi që në takim të "Zoom"-it nëse mbahet, Komiteti ynë me qenë këtu prezent.

Ermira Shabani theksoi se ju dërgojmë e-mail atyre kujt i kemi e-mailet e komiteteve, për ato komuna që nuk i kemi i dërgojmë në e-mail të Komunave dhe na tregojnë a kanë komitet dhe na qesin në kontakt me ta.

Mehreme Llumnica tha se për të hulumtuar komitetet në Ministrin e Pushtetit Lokal, i dinë ata se i menaxhojnë ato.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, tha se unë kontaktoj me Komunën e Ferizajt lidhur me ekzistimin e Komitetit në atë komunë dhe më 1 dhjetor me shkuar në Ferizaj, mirëpo paraprakisht duhet me nënkryetarin, z. Muhedin Nushi, të merremi vesh për sigurimin e transportit.

Të ndryshme

Mehreme Llumnica kërkoi sqarim për atë që u cek, janë bërë 10 mësues mbështetës, qysh prej fillimit është ngatërruar termi mësues mbështetës me asistentin personal. Unë e di, mësuesi mbështetës e mbështet vetëm mësuesen që ka shumë nxënës me aftësi të kufizuara, nuk merret shumë me personin që ka nevojë për asistent, ai i ndihmon mësuesit në klasë, ne e kemi dilemën te asistenti personal për nxënësit me aftësi të kufizuara që ka nevojë.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, tha Ministria e Arsimit i ka cekur detyrat e punës si për mësues mbështetës, për edukatorë mbështetës, për asistentë, ku janë detyrat e përcaktuara prej Ministrisë së Arsimit, DKA-së.

Ramadan Salihu tha se mësuesi personal nuk duhet me ekzistuar hiq, kjo është gabim katastrofal. Më mirë kishte me qenë me i obliguar me mësuar gjuhën e shenjave se me paguar pa lidhje mësues mbështetës.

Ermira Shabani tha se mësuesi mbështetës duhet kur ka një fëmijë me aftësi të kufizuara intelektuale, për shkak se ai i ndihmon procesin mësimor për ata. Problemi është se ky është gabim, se ai nuk është as për mësuesin as për nxënësin, këta janë duke e ngatërruar, ai është për tërësi të procesit mësimor. Problemi te është se këta po mendojnë që vetëm me shti një asistent apo mësues mbështetës veç atë me trajnuar, me punuar për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore, e këtë mësuesin klasor jo. Do të duhej të ndodhte e kundërta, duhet të dy me u aftësuar, pajtohem me zotëri Ramadanin, p.sh. me ditë mësuesi klasor edhe gjuhën e shenjave, alfabetin e Brajtit etj.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, tha se mësuesi mbështetës është për ta lehtësuar procesin mësimor, pastaj ai mësues mbështetës i trajnon mësimdhënësit.

Armend Ademi u shpreh se jam jashtë këtyre temave që po fliten. Nëse veç e kanë Rregulloren për fëmijët e shurdhër, që janë deri 5 fëmijë, mund t'i menaxhojë një asistent i gjuhës së shenjave, është 5:1, por nëse janë mbi 5-10 fëmijë duhet të jenë 2 asistentë, që me mundur me i përcjellë që mos me mbetur asnjë mbrapa.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, tha se Udhëzimi administrativ nuk po respektohet, sepse thuhet brenda shkollës duhet të jenë 25-30, ndërsa ne i kemi deri 40-45 nxënës dhe në Prishtinë e kemi gjendjen më alarmante, sepse është e pamundur me menaxhuar edhe asistentet, sepse numrin i fëmijëve me nevoja të veçanta është në rritje e sipër.

Mehreme Llumnica theksoi se shumë më e arsyeshme ka qenë me qenë mobil një mësues mbështetës, sesa një psikologe e shkollës i ka marrë 2-3 shkolla.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, tha njëjtë e kanë bërë 2 shkolla ta kenë një mësues mbështetës, i kanë pranuar 10, vetëm 4-5 i ke aktual, ata 15-16 tjerë janë duke munguar, sot kanë lypur kontratë me i sistemuar. As DKA-ja nuk janë duke ditur, as burimet njerëzore nuk kanë ditur mësuesve mbështetës me ua përpiluar kontratat.

Ermira Shabani tha se mësuesi mbështetës është figurë në kuadër të MASH-së që parashihet. Unë e shoh më problem çështjen e asistentëve të nivelit të 5-të, që ka dalë, p.sh asistenti te personat e verbër, dëgjim ose aftësi të kufizuara fizike, është e domosdoshme se ju ndihmon në mobilizim, në lëvizje etj., te kufizimi intelektual në rast se fëmija me Sindrom Down apo me Autizëm arrin me u gjendur brenda klasës dhe nuk ka nevojë me pasur asistent afër, atëherë asistenti ndikon negativisht se e bën të varur atë, andaj për këtë është mësuesi mbështetës që e ndihmon procesin në tërësi e jo vetëm një person.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, tha se Ministria e Arsimit më të arsyeshëm i ka pa asistentët personalë që t'u ofrohen rasteve më të rënda sesa fushës së intelektuales, si p.sh. tek Shoqata e Sindrom Down, fëmijën me Sindrom mundet me mbështetur edhe një mësues mbështetës.

Ermira Shabani pyeti ku është dallimi te ne, sepse jashtë, si p.sh. në Itali, ti e ke qartë figurën e mësuesit mbështetës, që është diçka tjetër, edhe e asistentit. Asistenti është dikush që ndihmon në aspektin fizik, lëvizje etj., ndërsa ky asistenti që po del si figurë tjetër te ne, unë po e shoh si miks, nuk po di me dalluar çka konkretisht çka po del, a është mësues mbështetës apo mu po më duket është të dyja.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, tha më shumë është si asistentë.

Mehreme Llumnica tha kryesuese ju po thoni se duhet një numër i madh i asistentëve, Komuna e Prishtinës dhe Ministria e Arsimit e kontraktton një kompani, si me i marrë këto Qendrat e Karrierës dhe siguron asistent personal.

Ermira Shabani tha se unë besoj shumë te kjo pjesa e gjithëpërfshirjes, edhe unë për këta po them se nëse ti i krijon kushtet ashtu, e krijon një mjedis fizik, infrastrukturë, i ke figurat e përgatitura, e ke mësuesin e klasës e përgatit, e ke mësuesin mbështetës, e ke shkollën e psikologëve, me logoped e krejt. E ke një numër të arsyeshëm të nxënësve në klasë etj., gjithçka shkon, i ke ekipet profesionale e krejt, besoj se ia del.

Ramadan Salihu tha më trego një Sindrom Down, më thuaj ku ka shkuar ai, në botën më të zhvilluar, p.sh. në Finlandë a ke ti ndonjë emër që e ke lexuar që ndonjë Sindrom Down që është bërë akademik në nivelin akademie.

Ermira Shabani theksoi se jo në nivel akademik nuk kemi, p.sh. në Amerikë kanë edhe në Universitet i kanë ato vitet universitare, p.sh programet që ua kanë përshtatur për dallim prej neve.

Ramadan Salihu theksoi se në shtetet e zhvilluara i kanë bërë qendrat trajnuese, ti ke mundësi mos me iu thënë në emër PAK, por që ti me bërë një PAK me barazuar me një nxënës tjetër dhe me thënë qitja një arsimitar mbështetës e ka me u bërë i njëjtë sikur ky, kjo është vetëm me gënjeje një PAK.

Ermira Shabani dha sqarime, duke thënë se sot në psikologjinë e edukimit dhe arsimit tash janë duke biseduar, d.m.th. studimet e fundit thonë se nuk po dihet a është i mirë ky modeli konvencional, me shkuar krejt një shkollë, krejt një klasë për shkak se secili fëmijë e ka mënyrën e vet se si i mëson gjërat e unë po flas për këtë mënyrë, e mandej të kapaciteteve se secili i ka kapacitetet e ndryshme.

Mehreme Llumnica theksoi se e kanë pasur një dilemë këta të Qendrës burimore, që ka shkua me dëmtime intelektuale më të rënda, p.sh. e kanë marrë një diplomë, e kanë krye 8-vjeçaren e

tash kanë mbetur pa kualifikim të mesëm, nuk kanë diplomë, e kanë kryer ndonjë zanat tashti as aty nuk kanë diplomë.

Ramadan Salihu tha se për atë shteti dhe ligji i integron, i punëson diku brenda asaj që e ka arritur, por të shkojë rregullisht si kurse këta tjerët e ti pengoj në mësim të tjerët kjo nuk është në rregull. Unë nuk jam mos me bërë asgjë për ta, por me bërë më shumë e ajo më shumë është integrimi funksional e jo integrimi politik.

Armend Ademi u interesua për e-mailin që është dërguar para një muaji lidhur me punën e parkingut, ku nuk ka marrë asnjë përgjigje, ndoshta është mirë prapë me iu shkrua se ndoshta nuk e kanë parë.

Fatime Demolli - Mustafa, kryesuese, dha sqarime duke cekur se ka përsëritur dy herë e-mailin si në Ministri të Arsimit, DAK, aktorët e asistentëve, njëjtë e kam përsëritur edhe këtë e-mailin e Armendit, unë jam takuar fizikisht me një person të Ministrisë së Arsimit, më ka thënë pritni deri sa të zgjidhen kryetarët e Komunave se njëherë nuk mundemi të bëjmë asgjë as ne këtu, as ju atje. Kjo ka qenë një përgjigje e tyre, përndryshe me dokumente me gjithë çka është në rregull Ministria e Arsimit, sepse vijën buxhetore e ka nda tash tri vjet për asistentë të fëmijëve me nevoja të veçanta. Nga ana e MASH-së është në rregull, vija buxhetore që ka hy në Komunën e Prishtinës nuk dihet ku është ndërprerë a çka është bërë, as këta vet nuk janë që e kanë dhënë ndonjë përgjigje konkrete Komuna.

Unë do ta marrë përgjegjësinë dhe prapë do t'u dërgojë e-mailin.

Në bazë të diskutimeve, anëtarët e Komitetit u dakorduan që:

- Më 2 dhjetor, të mbahet një takim online me komitetet e regjioneve të tjera dhe ky do të jetë takim i rregullt.
- Më 1 dhjetor, të vizitohet komitetin në kuadër të Komunës së Ferizajt.

Mbledhja përfundoi në orën 14:50.

**Procesmbajtësja:
Shyqre Islami**

**Kryesuesja e Komitetit
Fatime Demolli - Mustafa**

